

VENDIM
Nr. 612, datë 2.10.2024

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM LETRASH
TË MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR
FINANCIMIN SHITESË PËR PROJEKTIN “PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË
SHËNDETËSISË”, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 52/2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin shtesë për projektin “Përmirësimi i sistemit të shëndetësisë”, ratifikuar me ligjin nr. 52/2022, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

BANKA BOTERORE
IBRD . IDA I GRUP I BANKES
BOTERORE

XIAOQING YU
Drejtor vendi, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

ZYRA E GRUPIT TË BANKËS
BOTËRORE
Praterstrasse 31/21
Vienna, Austria, 1020

Shkëlqesisë së Tij, Ervin Mete
Ministër
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

5 qershor, 2024

I nderuar z. Ministër,

***Projekti për Përmirësimin e Sistemit Shëndetësor - financim shtesë (Numri i huas
9306-AL)***

Zgjatja e datës së mbylljes

Ne i referohemi Marrëveshjes së Huas (“Marrëveshja e Huas”) ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Huamarrësi”) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka Botërore”), datë 29 prill 2022, për financimin shtesë (FSH) të Projektit të Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor (“Projekti”) dhe letrës suaj të datës 27 maj 2024 që kërkon zgjatjen e datës së mbylljes së huas së lartpërmendur.

Ndërsa vërejmë kërkesën tuaj për një zgjatje të datës së mbylljes së huas deri më 31 dhjetor 2025, dëshirojmë t’iu informojmë se duke pasur tashmë parasysh kohën e gjatë të zbatimit të Projektit të Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor, Banka Botërore mund të pranojë vetëm një periudhë zgjatjeje

gjashtëmujore të datës së mbylljes së huas deri më 30 qershor 2025, si datë e mëvonshme për qëllimin e seksionit III.B.2 të skedulit 2 të Marrëveshjes së Huas.

Në shumë takime, ekipi ynë i ka përcaktuar në mënyrë të vazhdueshme ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) zgjatjen e lartpërmendur gjashtëmujore. Në ato raste, ne kemi marrë garanci se aktivitetet e mbetura pezull do të përfundojnë brenda afatit kohor të rishikuar (30 qershor 2025) me angazhimin e MSHMS-së dhe ekipit të Bankës Botërore për të punuar në një mënyrë të shpejtë dhe për të ruajtur mbikëqyrjen javore të aktiviteteve të projektit. Më tej, ekipi ynë ka përcjellë vazhdimisht se çdo aktivitet projekti që nuk mund të përfundojë deri në datën e rishikuar të mbylljes, do të duhet të merret përsipër nga Qeveria e Shqipërisë dhe të financohet nga burimet tuaja financiare.

Në përputhje me praktikën aktuale të Bankës, disbursime të mëtejshme nga Huaja do të bëhen për aplikimet për tërheqje të marra nga Banka në mbyllje të aktivitetit më 31 tetor 2025, në lidhje me shpenzimet e pranueshme të bëra deri në datën e mbylljes (specifikisht pagesat e kryera ose pagesat për mallra, punë dhe shërbime ose shpenzime të tjera të pranueshme që janë siguruar para datës së mbylljes). Të ardhurat e huas që mbeten të patërhequra pas kryerjes së disbursimeve në lidhje me këto aplikime për tërheqje, do të anulohen.

Me përjashtim të ndryshimeve specifike në këtë letër, të gjitha dispozitat e tjera të Marrëveshjes së Financimit mbeten në fuqi dhe efekt të plotë.

Me respekt,

Xiaoqing Yu

Drejtore vendi, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore
(*Nënshkrimi*)

Për dijeni: Shkëlqesisë së Saj, Albana Koçiu, ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Znj. Agathi Kurameno, shefe e Kabinetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Znj. Adela Xhemali, zv.ministre e Financave
Znj. Jona Suli, drejtore e SASPAC-ut
Z. Matteo Bugamelli, drejtor ekzekutiv i Bankës Botërore

Tel: +43 (1) 2170 782 Faks: +43 (1) 2170 701



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BORXHIT SHTETËROR
DREJTORIA E MARRËVESHJEVE DHE SIGURIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ

Nr. 8060/3
prot.

Tiranë, më 24.9.2024

Lënda: Mbi Projektin "Përmirësimi i sistemit të shëndetësisë".

ZYRËS SË BANKËS BOTËRORE
Adresa: "Dëshmoret e 4 Shkurtit" nr.34 Tiranë ✓

Për dijeni:

XIAOQING YU
Drejtoresh Rajonale, Ballkani Perëndimor

I referohem Marrëveshjes së Huasë për financimin shtesë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin "Përmirësimi i Sistemit të Shëndetësisë".

Në vijim të shkresës suaj datë 05.06.2024 ku konfirmoni shtyrjen deri më 30 Qershor 2025 të afatit të disbursimit të parashikuar sipas skedulit 2, neni III (B.2) të Marrëveshjes së Huasë për financimin shtesë, shprehim dakordësinë tonë me këtë afat.

Kjo letër së bashku me letrën tuaj do të përbëjnë marrëveshjen ndryshuese, me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huasë për financimin shtesë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin "Përmirësimi i Sistemit të Shëndetësisë".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

MINISTRI
Petrît Malaj